



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.NR. 156/11

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga Rafet Haxhaj kryesues, Xhevdet Abazi dhe Vlastimir Dimiq, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Njazi Gashi Kryetar i Këshillit Organizativ të Subjektit Politik Iniciativa Demokratike për Integrim (IDI) nga Prishtina, që ka të bëjë me pezullimin e partisë politike, në seancën e mbajtur me datë 16.02.2011 mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apeli si i pabazuar.

ARSYETIMI

Njazi Gashi, Kryetar i Këshillit Organizativ të Subjektit Politik IDI, ka parashtruar apel brenda afatit ligjor, kundër vendimit të KQZ-ZRPPC, me nr. 652/2011 të datës 11.02.2011 me të cilin ky subjekt është pezulluar nga regjistri i partive politike .

Parashtruesi i apelit ka deklaruar se KQZ nuk kishte marr për bazë kërkesën e tij të cilën e kishte përcjellur përmes shërbimit postar brenda afatit ligjor prej 6 muajsh, kur parashihej të mbahet kuvendi i parë themelues i partisë, sipas nenit 13.1 të Rregullës Zgjedhore 01/2008 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, kjo kërkesë për shkak të neglizhencës së shërbimit postar nuk është dërguar fare në ZRPPC. Ndërkohë, parashtruesi i apelit ka dërguar një kërkesë të tillë në ZRPPC ku ka paraqitur arsyet e shtyrjes së mbajtjes së kuvendit:

- Mos dërgimi i shkresës nga shërbimi postar në ZRPPC;
- Marrjen parasysh të rrethanave politike në Kosovë, me shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme të 12 dhjetorit 2010;
- Nevojën për një afat kohor të arsyeshëm, që ky subjekt i regjistruar me datën 19.04.2010, që të mund të konsolidohet në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet dhe Rregullat Zgjedhore në fuqi. Apeluesi kërkon shfuqizimin e Vendimit të KQZ-së dhe

të mundësoj afat të mjaftueshëm kohor për mbajtjen e kuvendit themelues të partisë politike IDI.

PZAP ka pranuar një apel më datë 14.02.2011 nga Njazi Gashi, nga radhët e Subjektit Politik IDI nga Prishtina, i cili ka apeluar vendimin e KQZ-ZRPPC me nr. 662 të datës 11.01.2011 me të cilin është pezulluar nga regjistri i partive politike për shkak të mos mbajtjes së kuvendit themelues të partisë politike, konform Rregullës Zgjedhore 01/2008 Për Regjistrimin e Partive Politike.

Parashtruesi i apelit ka përmendur disa arsye për shkak të cilave sipas tij nuk ka mundur të mbaj kuvendin themelues të partisë politike IDI brenda afatit ligjor siç është paraparë në Rregullën Zgjedhore 01/2008.

Fillimisht PZAP ka kërkuar nga KQZ-ZRPPC më datë 25.02.2011 një Kërkesë për Konfirmim, që të vërtetoj nëse Njazi Gashi në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Organizativ të Partisë Politike se a ka bërë ndonjë kërkesë për shtyrje të afatit për mbajtje të kuvendit themelues nga ZRPPC-ja si dhe me cilën datë ka pranuar këtë shkresë ZRPPC. Më datë 16.02.2011, PZAP ka pranuar Konfirmimin nga ZRPPC-ja lidhur me Kërkesën për Konfirmim nr. 156/2 të datës 15.02.2011, ku thuhet se shkresa e kryetarit të IDI-së “Kërkesë që ti jipet afat shtesë për shtyrje e mbajtjes së Kuvendit të parë themelues”, ZRPPC ka pranuar nga IDI si dëshmi dy shkresa njëra me datë 02.02.2011 me nr. të protokollit 652 si dhe shkresa tjetër po me të njëjtën datë dhe nr. të protokollit.

ZRPPC si dëshmi ka bashkangjitur këto dy shkresa me nr. të njëjtë të protokollit dhe datë të njëjtë, me nr. 652/2011.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

- **apeli është i pabazuar.**

Pezullimi i partive të regjistruara është e rregulluar me Rregullën Zgjedhore 01/2008,

Neni 6.1 KQZ-ja e pezullon nga regjistri partinë politike nëse partia:

a) nuk e ka informuar Zyrën në pajtim me nenin 13.5 të kësaj Rregulle se e ka mbajtur kuvendin zgjedhor brenda (6) muajve nga regjistrimi ose brenda tridhjetë e gjashtë (36) muajve, nga kuvendi i fundit zgjedhor;

Si dhe neni 13.5 i kësaj Rregulle parasheh:

Partia e regjistruar politike e informon Zyrën se ka mbajtur kuvendin e fundit jo më vonë se pesë (5) ditë pa mbajtjes së tij, me dorëzimin e kopjes së procesverbalit të kuvendit. Saktësia e procesverbalit vërtetohet nga kryetari i partisë.

Si rrjedhim PZAP konstatoj se pretendimet e parashtruesit te apelit janë të pavërteta dhe se të dy shkresat në ZRPPC janë të pranuar më datë dhe nr. të njëjtë të protokollit, për këtë arsye e refuzoi apelin si te pabazuar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 156/2011 më datën 16.02.2011.

**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**

